



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05-592

19.08.2019

Podujevë

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013, Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit në Podujevë shpallë:

KONKURS

**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË
GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN
SHKOLLOR 2019/2020**

1. Gjinnazi "Aleksandër Xhuvani" Podujevë

Nr.	Drejtimi - profili arsimor	Nr. i nxënësve
1.	Shkenca natyrore	50
Gjithsej 50 nxënës		

2. Shkolla e Mesme e Lartë Teknike "Fan S. Noli" Podujevë

Nr.	Drejtimet	Nr. i nxënësve	Vitet e shkollimit
1.	Elektroteknikë-Profilet:		
a.	Informatikë	10	2+1
b.	Telekomunikacion	34	2+1
c.	Postë dhe telekomunikacion	12	2+1
d.	Energjetikë	6	2+1
e.	Instalues elektrik	5	2+1
2.	Transport dhe trafik-profilet:		
a.	Transport rrugor	2	2+1
3.	Ndërtimtari-profilet:		
a.	Arkitekturë	13	2+1
4.	Makineri-profilet:		
a.	Saldator	24	2+1
b.	Automekanik	4	2+1
c.	Instalimi ngrohjes dhe klimatizimit	16	2+1
5	Tekstil-profilet:		
a.	Rrobaqepësi	12	2+1
Gjithsej 138 nxënës			

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2019/2020, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e IX- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2019/2020, bëhet më datat **19, 20 dhe 21 gusht 2019** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **8:00-16:00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **23.08.2019**.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **26.08.2019**.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe në MASHT - komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 (së pari gjendet mesatarja e lëndëve veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve porioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}}{4} \times 5 = 25 \text{ max}$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet me mesataren e notave të kl. 6 – 9 të $(5+5+5+5) = 20$; $20 : 4 = 5$)

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III)}}{3} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

Kur në profilin e caktuar kërkohen vetëm dy lëndë në këtë rast vlera e fituar pjesëtohet me 2 dhe shumëzohet me 3

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II)}}{2} \times 3 = 15 \text{ pikë max}$$

Në rast se kemi 5 lëndë prapë mblidhen mesataret e 5 lëndëve pjesëtohen me 5 dhe shumëzohen me 3

3. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjimnazi i shkencave natyrore** - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndet fizikë, kimi dhe biologji).

$$\text{p.sh. për tri lëndë: } \frac{\text{Kimi}(3) + \text{Biologji}(4) + \text{Fizikë}(5)}{3} = \frac{3+4+5}{3} = \frac{12}{3} = 4$$

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore** - Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, edukatë qytetare së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndet gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi)

për 5 lëndë:

$$\frac{\text{mes.gj.amtare} + \text{mes.gj.ang.} + \text{mes.his} + \text{mes.gjeo.} + \text{mes.qytet.}}{5} \times 3 = 15 \text{ pikë max.}$$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjimnazi i gjuhëve

1. Gjuhë shqipe 20 pikë
2. Gjuhë angleze 5 pikë (Gjithsej 25 pikë)

II. Shkencat shoqërore:

1. Gjeografi 12 pikë
2. Histori 13 pikë
(Gjithsej 25 pikë)

III. Matematikë

1. Matematikë 20 pikë
2. informatikë 5 pikë
(Gjithsej 25 pikë)

IV. Shkencat natyrore:

1. Fizikë 9 pikë
2. Kimi 8 pikë
3. Biologji 8 pikë (Gjithsej 25 pikë)

Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjinnazi shkencat e natyrës:		
1. Shkencat e natyrës 25		25 x 1.2 = 30 pikë
2. Matematikë dhe Informatikë 25		25 x 0.6 = 15 pikë
3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25		25 x 0.4 = 10 pikë
4. Shkencat shoqërore 25		25 x 0.2 = 5 pikë
		Totali = 60 pikë
II. Gjinnazi shoqëror dhe gjuhësor:		
1. Gj. Amtare, gj. angleze dhe shke. shoqërore 50		50 x 0.9 = 45 pikë
2. Matematikë dhe Informatikë 25		25 x 0.4 = 10 pikë
3. Shkenca natyrore 25		25 x 0.2 = 5 pikë
		Totali = 60 pikë

Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në shkolla profesionale

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari		
1. Shkencat natyrore 25		25 x 1.2 = 30 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25		25 x 0.6 = 15 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25		25 x 0.4 = 10 pikë
4. Shkencat shoqërore 25		25 x 0.2 = 5 pikë
		Totali = 60 pikë
II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji		
1. Matematikë dhe Informatikë 25		25 x 1.2 = 30 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25		25 x 0.6 = 15 pikë
3. Shkenca natyrore 25		25 x 0.4 = 10 pikë
4. Shkenca shoqërore 25		25 x 0.2 = 5 pikë
		Totali = 60 pikë
III. Ekonomi		
1. Matematikë dhe informatikë 25		25 x 1.2 = 30 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25		25 x 0.6 = 15 pikë
3. Shkenca shoqërore 25		25 x 0.4 = 10 pikë
4. Shkencat natyrore 25		25 x 0.2 = 5 pikë
		Totali = 60 pikë
IV. Juridik		
1. Shkencat shoqërore 25		25 x 1.2 = 30 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25		25 x 0.6 = 15 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25		25 x 0.4 = 10 pikë
4. Shkenca natyrore 25		25 x 0.2 = 5 pikë

Totali = 60 pikë

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25
2. Shkenca shoqërore 25
3. Matematikë dhe Informatikë 25
4. Shkenca natyrore 25

25 x 1.2 = 30 pikë

25 x 0.6 = 15 pikë

25 x 0.4 = 10 pikë

25 x 0.2 = 5 pikë

Totali = 60 pikë

Drejtori

Agim Blakçori

